



**ALKOOLI,
NËNA E TË KËQIJAVE**

Tiranë, 2023

Titulli i librit: **Alkooli, nëna e të këqijave**

I përzgjedhi dhe përktheu:

Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Redaktoi: **Jerida KULLA**

Korrekttoi: **Vjollca KARAJ**

Përkujdesja kompjuterike & kopertina:

Sabrie FEZA

Botoi: **Shoqata "Flladi"**

FJALA E BOTUESIT

**Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

*Falënderimet i takojnë Allahut të
Madhëruar. Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi
Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër
dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!*

I Dërguari i Allahut, vula e
profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi*)

i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), si dhe Ehli Bejti i tij i pastër (*Paqja qoftë mbi ta!*), na kanë lënë një trashëgimi madhështore, thëniet e tyre të bekuara, të cilat përfshijnë të gjithë jetën e njeriut. Nëse njeriu interesohet për ato thënie, i lexon, i kupton dhe i zbaton në jetën e tij të përditshme. Si rrjedhim, do të arrijë në përfundimin bindës se këto thënie të begata i sigurojnë atij lumturinë në të dyja jetët.

Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti i tij na nxisin që t'i mësojmë përmendësh hadithet e tyre, me qëllim që të bëhen pjesë e kulturës dhe e dukatës sonë dhe, me anë të tyre, të afrohemi tek Allahu i

Madhëruar. Kjo gjë ka shumë dobi për besimtarin në Jetën Tjetër.

Në një hadith të ardhur nga Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), thuhet: “Ai që mëson përmendësh dyzet hadithe, Allahu do ta ringjallë në Ditën e Kiametit të ditur dhe jurist (*fakih*)”.

Bazuar në këtë vlerë dhe pasuri të trashëguar nga Profeti Muhamed dhe Ehli Bejti, shoqata “Flladi” ka grumbulluar, ka përzgjedhur dhe ka përkthyer në gjuhën shqipe “**Alkooli, nëna e të këqijave**”.

Allahu na mbarësoftë të gjithëve në ruajtjen dhe përhapjen e kësaj trashëgimie të vyer e të begatë të Profetit Muhamed dhe të familjes së tij të pastër.

NDALIMI I PIJEVE ALKOOLIKE NË ISLAM DHE DËMET E TIJ, SIPAS MJEKËSISË

Në ajetin 195 të sures “El Bekare” thuhet:

وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ وَأَحْسِنُوا إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

**“...mos e çoni veten tuaj në shkatërrim,
por bëni të mira; Allahu, me të vërtetë, i
do bamirësit.”**

Ajeti 29 i sures “Et Teube” na
përmend një grup njerëzish që nuk u
binden urdhrave të Allahut.

وَلَا يُجْرِمُونَ مَا حَرَّمَ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَلَا يَدِينُونَ دِينَ الْحَقِّ

“...që nuk e marrin për të ndaluar atë që e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij që nuk e pranojnë fenë e vërtetë...”

Allahu i Madhëruar ia ka ndaluar njeriut çdo gjë që i shkakton dëm ose e dëmton në fenë e tij, në shpirtin e tij, në pasardhësit e tij, në mendjen e tij ose në pasurinë e tij.

Ndër gjërat e ndaluara, për të cilën flasin ajetet e Kur’anit të shenjtë, hadithet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të Ehli Bejtit, për ndalimin e tyre dhe urdhërojnë që të shmangen, është edhe

përdorimi i pijeve alkoolike. Pirja e alkoolit është mëkat i madh dhe ndalimi i tij është një nga të vërtetat e qarta të Islamit. Për këtë të vërtetë ka ajete nga Kur'ani dhe transmetime nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe nga familja e tij e pastër dhe e dëlirë. Përveç teksteve islame, ka plot thënie të ekspertëve të fushës së mjekësisë, të cilët flasin për dëmet shkatërruese dhe vdekjeprurëse të alkoolit.

Është shumë e qartë se në kohën e sotme prija e alkoolit është përhapur dhe është bërë diçka e zakonshme në mbarë botën, madje shumë myslimanë të devijuar e pijnë atë, pa i kushtuar

vëmendje ndalimit që urdhëron feja e tyre e pastër islame.

Nga ana tjetër, ne shohim edhe promovimin e saj përmes medieve të ndryshme, të shikueshme, të dëgjueshme dhe atyre të shkruara, qoftë edhe nga ato media që janë të lidhura me myslimanët, pa asnjë kokëçarje bëjnë reklamimin e pijeve alkoolike, duke i shoqëruar me femra thuajse të zhveshura.

Gjithashtu, shohim se pirja e alkoolit është bërë shpesh sinonim i festave, vallëzimeve dhe ahengjeve të shturura, gjë që ia shton shëmtinë kësaj plage të rrezikshme për sigurinë e shoqërisë.

Duke parë përhapjen e përdorimit të kësaj dukurie shkatërruese, e cila fatkeqësisht ka goditur brezin e ri, e konsiderojmë të nevojshme që neve, të cilëve na është besuar urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja, t'u tregojmë rrugën e duhur dhe t'i paralajmërojmë njerëzit për dëmin e kësaj vepre, për pasojat shkatërruese të saj në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër, duke shpresuar që Allahu t'i udhëzojë njerëzit në lënien e pirjes së pijeve alkoolike dhe largimin prej tyre.

Në mënyrë që kjo çështje të jetë sa më e qartë, sa më e kuptueshme dhe sa më e pranueshme, do ta shqyrtojmë në tri pjesë:

1- Në pjesën e parë, do të përmendim ndalimin e alkoolit në Kur'an.

2- Në pjesën e dytë, do të flasim për dëshmitë e shkencës së mjekësisë rreth dëmeve të mëdha që sjell pirja e alkoolit.

3- Në pjesën e tretë, do të përmendim ndalimin e alkoolit në hadithet profetike, duke sjellë 40 hadithe nga Profeti Muhamed dhe familja e tij e pastër rreth kësaj çështjeje.

PJESA E PARË

NDALIMI I ALKOOLIT NË KUR'AN

Ka disa ajete në Kur'anin e Shenjtë, që i referohen ndalimit të alkoolit, në formë të qartë e prerazi, edhe pse disa njerëz, fatkeqësisht, edhe ata që i thonë vetes së tyre myslimanë, ndonjëherë përpiqen ta anashkalojnë këtë çështje të qartë, duke u bazuar në iluzione apo në legjenda të kota.

Ndalimi i pijeve alkoolike në fenë e pastër islame është bërë në formë graduale. Ajetet që tregojnë ndalimin e konsumimit të pijeve alkoolike, janë:

1- Në suren “El Bekare”, ajeti 219 thuhet:

يَسْأَلُونَكَ عَنِ الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ قُلْ فِيهِمَا إِثْمٌ كَبِيرٌ وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ
وَإِثْمُهُمَا أَكْبَرُ مِنْ نَفْعِهِمَا...

“Të pyesin ty për verën dhe kumarin. Thuaju: ‘Ato sjellin dëme të mëdha (gjynahe), por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia’...”

Për sa i përket argumentit të ndalimit të pijeve alkoolike në këtë ajet, ai bazohet në parimin: “Kur dëmet e diçkaje

janë qartësisht më të mëdha se dobitë e saj, ajo është e ndaluar”. Kështu që dëmet e alkoolit janë qartësisht më të mëdha se dobitë e tij dhe fitimet që vilen nga alkooli, janë të ndaluara (të paligjshme) në Sheriatin e pastër islam. Te përdorimi i alkoolit gjendet dëm i madh në këtë jetë dhe dënim i pashmangshëm në Jetën Tjetër, nëse nuk hiqet dorë prej tij.

2- Në suren “En Nisa”, ajeti 43, thuhet:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْرَبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَارَى حَتَّى تَعْلَمُوا مَا تَقُولُونَ...

“O ju që keni besuar. Mos u falni, kur jeni të dehur, prisni të kthjelloheni e të dini se ç’flisni...”

Ndalohej falja e namazit në gjendje të dehur, sepse namazi nuk është i rregullt. Filozofia e këtij ndalimi është e qartë, sepse namazi është bashkëbisedimi i robit me Zotin e vet. Robi i lutet e i kërkon falje Zotit. Të gjitha këto duhet të kryhen patjetër në një gjendje plotësisht të kuptueshme e të kthjellët, kurse të dehurit janë shumë larg nga kjo gjendje. Allahu i Lartësuar thotë: **“O ju që keni besuar. Mos u falni, kur jeni të dehur, prisni të kthjelloheni e të dini se ç’flisni...”**

3- Ajetet 90-91 të sures “El Maide”, thonë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ مِّنْ
عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ * إِنَّمَا يُرِيدُ الشَّيْطَانُ أَنْ

يُوقِعِبَيْنَكُمْ الْعَدَاوَةَ وَالْبَغْضَاءَ فِي الْخَمْرِ وَالْمَيْسِرِ وَيَصُدُّكُمْ
عَنْ ذِكْرِ اللَّهِ وَعَنِ الصَّلَاةِ فَهَلْ أَنْتُمْ مُنْتَهُونَ

“O që keni besuar! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t’ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?”

Argumenti i ajeteve 90-91 të sures “El Maide”, për ndalimin e alkoolit është i qartë dhe i prerë, pasi urdhri për t’u larguar nga pirja e alkoolit është treguesi

më i fortë i ndalimit. Në ajet shohim se Allahu i Madhëruar nuk thotë: “Mos pini alkool”, por thotë largohuni prej atyre punëve të ndyta, ndër të cilat është edhe alkooli.

PJESA E DYTË

DËSHMITË E SHKENCËS SË MJEKËSISË RRETH DËMEVE TË MËDHA QË SJELL PIRJA E ALKOOLIT¹

Pirja e alkoolit është shumë e përhapur, saqë tashmë është bërë modë edhe në radhët e të rinjve. Ky është dhe shkaku

¹ Marrë nga:

<https://sot.com.al/sh%C3%ABndeti/d%C3%ABmet-q%C3%AB-i-shkakton-alkooli-trupit-tuaj>

kryesor i shtimit të rasteve me steatozë alkoolike dhe cirrozë në mëlçinë e konsumuesve të rregullt të alkoolit. Dëmet prej tij shkaktohen më së shumti në mëlçi, tru dhe më pak në zemër. Në mëlçi, alkooli i konsumuar, shkakton dëmtime të qelizave hepatike, dëmtim që rritet në kohë, duke u varur nga doza e konsumuar, kohëzgjatja e konsumit, si dhe nga veçoritë fiziologjike të individit.

Njerëzit që pinë prej vitesh alkool, që nuk ndiejnë gjë, papritur, një ditë gjenden para një fakti të hidhur. Mëlçia e tyre ka marrë fund, duke u kthyer në një mëlçi steatozike, ose më keq akoma, në mëlçi cirrotike. Ata mund të kenë pasur shqetësime të lehta, që nuk ia kanë vënë veshin, pasi

prekja e mëlçisë nga alkooli shpesh është asimptomatike. Nuk janë të pakta rastet kur zbulimi i një dëmtimi hepatic bëhet në ekzaminimet rutinë që bëjnë pacientët, ose në testet e funksionit hepatic që ata realizojnë (gjak komplet për matjet e bilirubinës, fosfatazës alkaline, kohës së protrombinës, aminotransferazave, gama glutamil transpeptidaza etj).

Jo pak dëmtime nga alkooli pëson edhe pankreasi. Pirja e vazhdueshme e alkoolit dëmton në mënyrë kronike pankreasin, deri në atë shkallë, sa ai nuk arrin të sekretojë sasinë e duhur të enzimave pankreatike, për të kryer të plotë procesin e tretjes së ushqimeve, sidomos të yndyrave të marra me dietën ushqimore.

Alkooli shkakton, gjithashtu, gjendjen e të dehurit, në të cilën sistemi nervor qendror nuk arrin të kontrollojë veprimet e vullnetshme apo të pavullnetshme të personit në fjalë.

Dëmi më i madh vjen nga përdorimi afatgjatë. Është vërtetuar se për çdo 1 litër alkool, vdesin 1000-2000 neurone, qeliza funksionale të trurit, të cilat nuk rigjenerohen më, pas dëmtimit. Kështu që përdoruesit kronikë të alkoolit, me kohë, shkojnë drejt demencës (skizofreni, marrëzi, degjenerim mendor etj).

Pra, alkooli dëmton, pa përjashtim, të gjitha organet e trurit. Përveç kësaj, edhe vetë cirroza e zhvilluar në mëlçi, shfaqet me

dëmtim të trurit, si pasojë e shtimit të toksinave në trup, që normalisht duhet të metabolizoheshin prej mëlçisë. Një mëlçi jo tepër funksionale nuk ka se si t'i largojë këto toksina, duke bërë të mundur grumbullimin e tyre në organizëm dhe dëmtimin e trurit.

Dëmet që sjell prija e alkoolit²

Alkooli është një substancë që mund të krijojë vartësi. Përdorimi dhe, për më tepër, abuzimi, mund të shkaktojë një sërë problemesh personale, familjare, financiare,

² Marrë nga:

<https://www.koha.net/lifestyle/146702/alkooli-demet-qe-i-shkakton-shendetit/>

ligjore, arsimore, sociale, aksidente dhe vdekje.

Shpesh, alkooli nis me një gotë, në një moshë fare të vogël, në një fundjave apo në festa me miqtë. Me kalimin e kohës shtohet sasia e konsumuar, aq sa krijohet vartësi. Sipas një studimi të bërë nga Instituti i Shëndetit Publik, rezulton se 2 në 3 nxënës të klasave të nënta dhe vitet e para në gjimnaz pohojnë të kenë pirë pije alkoolike, madje deri në dehje.

Konkretisht studimi evidenton se 67% e të rinjve kanë treguar se kanë konsumuar alkool. Madje ka një prirje në rritje të vajzave që pinë alkool. Por pirja e alkoolit në moshë të re shkakton probleme

të mëdha ekonomike dhe shëndetësore. Një studim i fundit tregon se tek të rinjtë, nën 20 vjeç, pirja e alkoolit krijon vartësi, është kancerogjen, përkeqëson disponueshmërinë, dëmton trurin dhe krijon predispozitë për demenzë.

Alkooli krijon vartësi

Alkooli është i krahasueshëm me drogën dhe te të rinjtë mund të jetë i rrezikshëm, sikurse e shpjegon studimi, pasi mund të komprometojë zhvillimin e trurit, zona limbike, për shembull, maturohet pas moshës 20 vjeç. Ja përse, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pirja e

alkoolit ndalohet nën moshën 21 vjeç. Nga ana tjetër, thuhet se sasi “të sigurta” janë: nën një gotë verë për gratë (të barabarta me një birrë të vogël ose një gotë liker) dhe për meshkujt, dy gota në ditë.

Është kancerogjen

Të dhënat shkencore tregojnë për një lidhje mes tumoreve dhe alkoolit, për të paktën 7 lloje tumoresh, (në gojë, faring, laring, ezofag, mëlçi, pankreas, zorrës së trashë-rektum dhe gjirit. Ndërsa studimi i EPIC (European Prospective Investigation into Cancer and Nutrition), nënvizon se pirja e alkoolit lidhet me 10 për qind të

kancerit mashkullor dhe 3 për qind të kancerit femëror.

Dobëson sistemin imunitar

Alkooli ndikon negativisht në organe të ndryshme, mes të cilave mëlçia. Gjithashtu, jep një ndjeshmëri më të madhe ndaj infeksioneve, krijon dëme direkte, sikurse është cirroza e mëlçisë.

Redukton përthithjen e vitaminave

Me pirjen e alkoolit, trupi ynë nuk përthith disa vitamina, sikurse janë

vitaminat e grupit B, vitaminat e grupit A, D dhe E.

Shkakton kequshqyerje

Nga ana tjetër, përkeqëson kapacitetin për përthithjen e lëndëve ushqyese të zorrëve. Për këtë arsye, nëse ekzagjerohet, rreziku i kalimit në kequshqyerje dhe ndryshimi i peshës së trupit është i konsiderueshëm.

Ul disponibilitetin

Abuzimi me alkoolin ndikon negativisht në ekuilibrin e përgjithshëm metabolik. Një ndikim i dukshëm dhe i

njohur është ndryshimi i fertilitetit, por edhe i performancës seksuale, te të dyja gjinitë përkeqësohet shumë, kur tejkalohet masa e pirjes së alkoolit.

Shumë i rrezikshëm në shtatzani

Alkooli mund të krijojë probleme të mëdha në mëlçi te fetusit, duke penguar një zhvillim korrekt të sistemit nervor qendror. Prandaj, në shtatzani, ndalohet pirja e alkoolit.

Ndërhyn tek ilaçet

Shumë ilaçe metabolizohen nga sistemet e njëjta të përdorura nga alkooli

që, për rrjedhojë, mund të rrisin ose të zvogëlojnë efektivitetin e tyre.

Dëmton funksionet njohëse, predispozitë për demenzë

Alkooli dëmton trurin, shkakton infarkte, një gjendje inflamimi e vazhdueshme, që komprometon aftësinë për të arsytuar në një mënyrë krejtësisht të qartë. Për më tepër, alkooli është faktor rreziku për dëmtimin e aftësisë njohëse.

Redukton kohët e reagimit

Pirja e alkoolit ndryshon hapësirën e vëmendjes dhe shkakton përgjumje, ndaj

dhe nuk duhet kurrësi të pihet, kur ngisni makinën, sepse mund të rrisë ndjeshëm aksidentet rrugore.

Mendojmë se janë të mjaftueshme këto dëshmi të mjekësisë për dëmet e mëdha dhe vdekjeprurëse të pirjes së alkoolit.

PJESA E TRETË

NDALIMI I PIRJES SË ALKOOLIT NË HADITHET PROFETIKE

Burimi i dytë i Sheriatit të pastër islam është suneti i Profetit Muhamed dhe i familjes së tij të pastër e të dëlirë.

Në Kur'anin e Shenjtë ka ajete që na urdhërojnë t'i bindemi të Dërguarit të Allahut, duke zbatuar porositë dhe urdhrat e tij. Po përmendim disa prej atyre ajeteve:

Në suren “El Ahzab”, ajeti 36, thuhet:

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا مُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ
الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ ۗ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ صِلًا مَبِينًا

“Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”

Në suren “Hashr”, ajeti 7, thuhet:

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.”

مَنْ يُطِيعَ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ ۖ

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...”³

Në këto ajete të begata shihet qartë se është detyrë zbatimi i porosive dhe i urdhrave të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ndër to, janë edhe urdhrat dhe porositë për largimin nga përdorimi i pijeve alkoolike.

Në vijim kemi përzgjedhur 40 hadithe nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Ehli Bejti i tij i pastër e i

³ Sure “Nisa”, ajeti 80

dëlrirë, që flasin për ndalimin e alkoolit, për dëmet e tij dhe për dënimin që e pret individin në Jetën Tjetër, nga pirja e alkoolit.

**40 HADITHE
RRETH NDALIMIT
TË PIRJES SË ALKOOLIT**

Hadithi 1

Alkooli dhe besimi kurrë nuk bashkohen

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Kurrë nuk bashkohet alkooli dhe besimi në brendinë dhe në zemrën e një njeriu”*.⁴

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
لا تجمع الخمر والإيمان في جوف أو قلب رجل أبدا.

⁴ “El Biharu”, vëll. 79, Haithi 152, f. 58.

Hadithi 2

Të mallkuarit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Allahu e ka mallkuar alkoolin, shtrydhësin e tij, kultivuesin (*ruajtësin*) e tij, pirësin e tij, atë që e shërben atë (*alkoolin*), shitësin e tij, blerësin e tij dhe atë që ushqehet me vlerën (*të ardhurat*) e tij, mbartësin e tij dhe atë (*mjetin*) me të cilin e mbart atë (*alkoolin*)”.⁵

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

لعن الله الخمر، وعاصرها، وغارسها، وشاربها، وساقيا، وبائعها، و
مشتريها، وأكل ثمنها، وحاملها، والمحمولة إليه.

⁵ Amali i Sadukut, Hadithi 1, f. 346.

Hadithi 3

Alkooli është nëna e të këqijave

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Alkooli është nëna e të këqijave dhe e mëkateve të mëdha”.⁶

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

الخمير أم الفواحش والكبائر.

⁶ “Kenzul Ummal”, Hadithi 13181.

Hadithi 4

Alkooli është nëna e të ndytave

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Alkooli është nëna e të ndytave”.⁷

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

الخمير أم الخبائث.

⁷ “Kenzul Ummal”, Hadithi 13183.

Hadithi 5

Përdoruesi i alkoolit është përgënjeshtres

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Pirja e pijeve alkoolike është çelësi i të gjitha të këqijave. Përdoruesi i alkoolit është përgënjeshtres i Librit të Allahut të Madhëruar e të Lartësuar. Nëse do të besonte librin e Allahut, do të ndalonte të ndaluarat (haramet) e tij”.⁸

قال الإمام الصادق (عليه السلام):
شرب الخمر مفتاح كل شر، وشارب الخمر مكذب بكتاب الله عز و
جل، ولو صدق كتاب الله حرم حرامه.

⁸ “Theuabul A'mal”, vëll. 2, Hadithi 12, f. 291.

Hadithi 6

Alkooli është tubuesi i mëkateve

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Alkooli është tubuesi i mëkateve, nëna e të ndytave dhe çelësi i të këqijave”.⁹

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
الخمير جامع الإثم، وأم الخبائث، ومفتاح الشر.

⁹ “Biharul Enuar”, vëll. 79, Hadithi 58, f. 149.

Hadithi 7

Pirja e alkoolit është çelësi i së keqjes

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“E gjithë e keqja është vendosur në një shtëpi dhe çelësi i saj është pirja e alkoolit”.¹⁰

7- قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

جمع الشركه في بيت، وجعل مفتاحه شرب الخمر.

¹⁰ “Biharul Enuar”, vëll 58, Hadithi 58, f. 148.

Hadithi 8

Çelësat e drynave për të këqijat është pirja e alkoolit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Allahu ka vendosur dryna për të këqijat dhe
çelësat e atyre drynave është pirja e alkoolit. Më
e keqe se pirja e alkoolit, është gënjeshtër”.¹¹

قال الإمام الصادق (عليه السلام):

إن الله جعل للشرب أفتقلا، وجعل مفاتيح تلك الأفتقال الشراب، وأ
شر من الشراب الكذب.

¹¹ “Theuabul A'mal”, Hadithi, 8, f. 291.

Hadithi 9

Ndalimi i uljes në tryezën që gjendet alkool

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Mos u ulni në atë tryezë ku pihet alkool, sepse
robi (njeriu) nuk e di se kur do të të vdesë”.¹²

قال الإمام علي (عليه السلام):
لا تجلسوا على مائدة يشرب عليها الخمر، فإن العبد لا يدري متى
يؤخذ.

¹² “El Khisalu”, Hadithi 10, f. 619.

Hadithi 10

Mos u ul në tryezën ku pihet alkool

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Kush beson Allahun dhe Jetën Tjetër, të mos ulet në tryezën ku pihet alkool”.¹³

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

من كان يؤمن بالله واليوم الآخر فلا يجلس على مائدة يشرب عليها
الخمر.

¹³ “El Khisalu”, Hadithi 215, f. 164.

Hadithi 11

Mallkimi në tryezën ku pihet alkool

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*I mallkuar, i mallkuar është ai që ulet me vullnetin e tij në tryezën ku pihet alkool*”.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

ملعون ملعون من جلس طائعا على مائدة يشرب عليها الخمر.

Hadithi 12

Shkaku i ndalimit të alkoolit

Kur Mufadal e pyeti Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për shkakun e ndalimit të alkoolit, Imami i ka thënë: *“Allahu e ndaloi alkoolin për shkak të shkatërrimit që ai sjell, sepse i varuri prej alkoolit shfaq rrëqethje, rrahje të shpejta të zemrës nga frika, i shkatërrohet personaliteti, e bën të guximshëm në kryerjen e mëkateve, shkakton gjakderdhje; përdoruesi i tij kryen prostitucion, atij (kur dehet) nuk i besohet shfajësimi i përdhunimit të të afërmeve të tij, femra. Alkoolistit i shtohen më shumë të këqijat”*.¹⁴

¹⁴ “Ilelu Esh Sheraia”, Hadithi 2, f. 476.

قال الإمام الصادق (عليه السلام)

– عندما سأله المفضل عن علة تحريم الخمر – :

حرم الله الخمر لفعالها وفسادها، لأن مدمن الخمر تورثه الارتعاش، وتذهب بنوره، وتهدم مروته، وتحمله على أن يجترئ على ارتكاب المحارم، وسفك الدماء، وركوب الزنا، ولا يؤمن إذا سكر أن يثب على حرمه ولا يعقل ذلك، ولا يزيد شاربها إلا كل شر.

Hadithi 13

Bëmat e alkoolit

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Bëmat e alkoolit ngrihen mbi çdo mëkat, ashtu
siç lartësohen pemët mbi njëra-tjetrën”.¹⁵

قال الإمام الباقر (عليه السلام):

أفاعيل الخمر تعلو على كل ذنب كما تعلو شجرتها على كل شجرة.

¹⁵ “Biharul Anuar”, vëll. 79, Hadithi 51, f. 141.

Hadithi 14

Alkooli e çon pirësin e tij në mohimin e Allahut të Madhëruar

Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Allahu e ka ndaluar alkoolin për arsye të të këqijave që gjenden në të. Prej atyre të këqijave është se ai ia ndryshon mendjen pirësit të tij dhe e çon në mohimin e Allahut të Madhëruar e të Lartësuar, në shpifje ndaj Tij dhe ndaj të Dërguarve të Tij. E çon pirësin e tij në vepra të tjera të këqija, prej të cilave janë shkatërrimi dhe vrasja”.¹⁶

¹⁶ “Ujun Akhabari Rida alejhis selam”, vëll. 2, f. 2, Hadithi 98.

قال الإمام الرضا (عليه السلام):

حرم الله الخمر لما فيها من الفساد، ومن تغييرها عقول شاربها، وحمل
ها إياهم على إنكار الله عز وجل، والفرية عليه وعلى رسله،
وسائر ما يكون منهم من الفساد والقتل.

Hadithi 15

Ndëshkimi i pirësit të alkoolit

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Ai që pi alkool dhe e di që është haram (i ndaluar), Allahu do t’i japë të pijë gjak dhe qelb që del nga banorët e Xhehenemit”.¹⁷

قال الإمام علي (عليه السلام):

من شرب الخمر وهو يعلم أنها حرام سقاه الله من طينة خبال.

¹⁷ “El Khisalu”, Hadithi 10, f. 621.

Hadithi 16

Alkooli çon deri në paganizëm

*“Imam Aliu (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë:
“Ai që është i varur nga alkooli, do ta takojë
Allahun si të jetë pagan”.*¹⁸

قال الإمام علي (عليه السلام):

مدمن الخمر يلتقى الله عز وجل حين يلقاه كعابد وثن، قال – راوي
– قلت له وما المدمن ؟ قال: الذي إذا وجدها شربها.

¹⁸ “El Kafij”, vëll. 6, Hadithi 1, f. 405.

Hadithi 17

Mos i besoni pirësit të alkoolit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Mos i besoni pirësit të alkoolit, kur flet; mos e shikoni në fytyrë, kur bisedon; mos e vizitoni, kur sëmuret; mos e shoqëroni xhenazen e tij, kur të vdesë dhe mos ia besoni atij amanetet”.¹⁹

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

شارب الخمر لا تصدقوه إذا حدث، ولا تزوجوه إذا خطب، ولا ت
عودوه إذا مرض، ولا تحضروه إذا مات، ولا تأمنوه على أمانة.

¹⁹ “El Biharu”, vëll. 79, Hadithi 7, f. 127.

Hadithi 18

Pirësit e alkoolit janë të përbuzur

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Mos u ulni me pirësit e alkoolit, mos i vizitoni të sëmurët e tyre, mos i shoqëroni xhenazetë e tyre, mos ia falni namazin të vdekurve të tyre, sepse ata janë qentë e banorëve të Zjarrit, siç thotë Allahu: “**Ai do t’u thotë: ‘Rrini aty të përbuzur dhe mos më flisni asgjë!’**”^{20,21}

²⁰ “El Biharu”, vëll. 79, Hadithi 7, f. 127.

²¹ “Sure “El Mu'minun”, ajeti 108.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

لا تجالسوا مع شارب الخمر، ولا تعودوا مرضاهم، ولا تشيعوا
جنائزهم، ولا تصلوا على أمواتهم، فإنهم كلاب أهل النار كما قال
الله * (اخسؤا فيها ولا تكلمون) *.

Hadithi 19

Allahu është i zemëruar me alkoolistin

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“Alkoolisti është si squfuri, prandaj ruhuni prej tij, që të mos ju qelbë, ashtu siç qelbet squfuri. Alkoolisti gdhahet dhe ngryset dhe Allahu është i zemëruar me të. Ai që fle i/e dehur, shejtani do të jetë nusja/dhëndri i tij deri në mëngjes. Kur të zgjohet, ai/ajo duhet të lahet, ashtu siç lahet për xhynybllek”*.²²

²² “El Bihar”, vëll. 79, Hadithi 58, f. 150.

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

مثل شارب الخمر كمثل الكبريت فاحذروه لا ينتنكم كما ينتن الكبريت
وان شارب الخمر يصبح ويمسي في سخط الله، وما من أحد
يبيتسكران إلا كان للشيطان عروسا إلى الصباح، فإذا أصبح
وجب عليه أن يغتسل كما يغتسل من الجنابة.

Hadithi 20

Mjerim për atë që fle i/e dehur

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Kush fle i/e dehur, do të jetë nuse/dhëndër për shejtanin”.²³

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

من بات سكرانا بات عروسا للشيطان.

²³ “El Bihar”, vëll. 79, Hadithi 58, f. 148.

Hadithi 21

Cilësitë e alkoolistit

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Të dehurit prej banorëve të Err Rrajit në
dynja, do të vdesin të etur, do të tubohen të
etur dhe do të hyjnë në zjarr të etur”.*²⁴

قال الإمام الصادق (عليه السلام):
إن أهل الري في الدنيا من المسكر يموتون عطاشا ويحشرون
عطاشا ويدخلون النار عطاشا.

²⁴ “Theuabul A'mali”, vëll. 2, Hadithi 4, f. 290.

Hadithi 22

Shpërfytyrimi i alkoolistit në Ditën e Kiametit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “I varuri ndaj alkoolit dhe i dehuri prej tij do të vijnë në Ditën e Kiametit me sy ngjyrë blu, me fytyrë të nxirë, i shtrembëruar nga një anë dhe me jargë të varura”.²⁵

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
يحيى مدمن الخمر المسكر يوم القيامة مزرقه عيناه، مسودا وجهه،
مائلا شقه، يسيل لعابه.

²⁵ “Theuabul A'mali”, vëll. 2, Hadithi 4, f. 290.

Hadithi 23

Alkoolisti është larg mëshirës së Allahut

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Alkoolisti do të dalë nga varri i tij dhe në mes të dy syve të tij është shkruar: ‘I larguar nga mëshira e Allahut!’”²⁶

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):

يخرج الخمار من قبره مكتوب بين عينيه : آيس من رحمة الله.

²⁶ “Kenzul Ummali”, Hadithi 43958.

Hadithi 24

Çfarë fatkeqësie për alkoolistin?

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Betohem në atë që më dërgoi me të vërtetë Profet, se alkoolisti do të vijë në Ditën e Kiametit me fytyrë të nxirë, do të godasë tokën me kokë dhe do të thotë: ‘Ah ç’mjerim! Jam i etur’”.²⁷

قال رسول الله (صلى الله عليه وآله):
والذي بعثني بالحق نبيا، إن شارب الخمر يأتي يوم القيامة مسودا
وجمه، يضرب برأسه الأرض وينادي وا عطشاه.

²⁷ “Tenbijhul Khauatirri”, vëll. 2, f, 115.

Hadithi 25

Ndalimi i alkoolit

Er Rida (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Allahu nuk dërgoi një profet veçse për të
ndaluar alkoolin dhe për t’i vërtetuar atij se
Allahu bën çfarë të dojë”.²⁸

عَنِ الرَّضَا عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ: مَا بَعَثَ اللَّهُ نَبِيًّا إِلَّا بَيَّحَرَ إِلَى نَبِيِّهِ الْخَمْرَ،
وَ أَنْ يَقْرَأَهُ بِأَنَّ اللَّهَ يَفْعَلُ مَا يَشَاءُ.

²⁸ “Biharul Enuar”, vëll. 79, Hadithi 134.

Hadithi 26

Alkooli largon besimin

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Kush pi alkool, drita e besimit del nga brendia e tij”.²⁹

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: مَنْ شَرِبَ خَمْرًا خَرَجَ نُورُ
الْإِيمَانِ مِنْ جَوْفِهِ .

²⁹ “Kenzul Ummal”, vëll. 5, Hadithi 13180.

Hadithi 27

Kur'ani do të jetë kundërshtari i alkoolistit në Ditën e Kiametit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kushdo që në zemrën e tij ka një ajet Kur’ani apo një germë dhe mbi të hedh alkool (pi alkool), Kur’ani do të jetë kundërshtari i tij në Ditën e Kiametit”.³⁰

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ كَانَ فِي قَلْبِهِ آيَةٌ مِنَ الْقُرْآنِ أَوْ حَرْفٌ فَصَبَّ عَلَيْهَا الْخَمْرَ يَوْمَ الْقِيَامَةِ يُخَاصِمُهُ الْقُرْآنُ .

³⁰ “Biharul Enuar”, vëll. 79, Hadithi 148.

Hadithi 28

Mos u ul me pirësin e pijeve alkoolike

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
*“Mos u ulni me pirësin e pijeve alkoolike, sepse,
kur zbret mallkimi, i përfshin të gjithë të
ulurit”*.³¹

قَالَ الصَّادِقُ عَلَيْهِ السَّلَامُ : لَا تُجَالِسُوا شُرَابَ الْخَمْرِ فَإِنَّ اللَّعْنَةَ
إِذَا نَزَلَتْ عَمَّتْ مَنْ فِي الْمَجْلِسِ .

³¹ “El Hikem Ez Zahireh”, Hadithi 301.

Hadithi 29

Alkoolisti është larg Profetit (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në prag të vdekjes, ka thënë: “Nuk është prej meje ai që nënvleftëson namazin e tij. Betohem në Allah, se ai nuk do të jetë me mua te Burimi (Haudhi). Nuk është prej meje ai që pi pije dehëse. Betohem në Allah, se ai nuk do të jetë me mua te Burimi (Haudhi)”.³²

³² “Biharul Enuar”, vëll. 79, Hadithi 136.

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ عِنْدَ مَوْتِهِ:

لَيْسَ مِنِّي مَنْ اسْتَحَفَّ بِصَلَاتِهِ، لَا يَرِدُ عَلَى الْحَوْضِ لَا وَاللَّهِ، لَيْسَ
مِنِّي مَنْ شَرِبَ مُسْكِرًا، لَا يَرِدُ عَلَى الْحَوْضِ لَا وَاللَّهِ.

Hadithi 30

Dënimi i alkoolistit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Kush pi një gllënjë (baskatun) me alkool, goditeni me tetëdhjetë gjuajtje me kamxhik”.³³

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

مَنْ شَرِبَ بِصَقَّةٍ مِنْ خَمْرٍ فَاجْلِدُوهُ ثَلَاثِينَ.

³³ “Kenzul Ummal”, vëll. 5, Hadithi 13186.

Hadithi 31

Alkolisti nuk hyn në Xhenet

Ebu Abdilahu ka transmetuar nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!): “Katër grupe nuk do të hyjnë në Xhenet: 1- fallxhorët 2- hipokritët 3- pijanecët 4- thashethemexhinjtë”.³⁴

عَنْ أَبِي عَبْدِ اللَّهِ عَلَيْهِ السَّلَامُ قَالَ:

أَرْبَعَةٌ لَا يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ: الْكَاهِنُ وَالْمُنَافِقُ، وَ مُدْمِنُ الْخَمْرِ
وَالْقَتَاتُ وَ هُوَ التَّمَامُ.

³⁴ “Kenzul Ummal”, vëll. 5, Hadithi 13186.

Hadithi 32

Alkooli çon në degjenerim

Kur e kanë pyetur Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), nëse alkooli është më i keq se kurvëria (zinaja) dhe vjedhja, ai është përgjigjur: “Po, sepse ai që pi alkool kurvëron, vjedh, vret dhe lë namazin”.³⁵

عَنْ عَلِيٍّ عَلَيْهِ السَّلَامُ أَنَّهُ قِيلَ لَهُ:

لَئِنَّ الْخَمْرَ أَشَدُّ مِنَ الزَّانَا وَالسَّرْقَةِ؟ قَالَ: نَعَمْ لَئِنَّ شَارِبَ الْخَمْرِ
يَزْنِي وَ يَسْرِقُ وَ يَقْتُلُ وَ يَدَعُ الصَّلَاةَ.

³⁵ “Kenzul Ummal”, vëll. 5, Hadithi 13693.

Hadithi 33

Alkooli është degëzuesi i mëkateve

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Ruhuni nga pijet alkoolike, sepse mëkati i tyre degëzon mëkate, ashtu si nga pema dalin degë të tjera”.³⁶

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

إِيَّاكُمْ وَالْحَمْرَ فَإِنَّ خَطِيئَتَهَا تُفْرَعُ الْخَطَايَا كَمَا أَنَّ شَجَرَتَهَا تُفْرَعُ

الشَّجَرَ.

³⁶ “Nehxhul Fasahati”, Hadithi 989.

Hadithi 34

Allahu në Ditën e Kiametit nuk e shikon alkoolistin

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “*Katër persona nuk i shikon Allahu në Ditën e Kiametit: keqtrajtuesi i prindëroë, thashethemexhiu, përgënjeshtuesi (mohuesi) i kaderit dhe alkoolisti*”.³⁷

قال رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: "أَرْبَعَةٌ لَا يَنْظُرُ اللَّهُ إِلَيْهِمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ: عَاقٌّ، وَمَتَانٌّ، وَ مُكَذِّبٌ بِالْقَدَرِ وَمُدْمِنٌ خَمْرٍ."

³⁷ "Biharul Enuar", vëll. 79, f. 129.

Hadithi 35

Llojet e dënimit të alkoolistit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *"Pirësin e pijeve alkoolike, Allahu do ta dënojë me treqind e gjashtëdhjetë lloje dënimi"*.³⁸

قال رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:
"شَارِبُ الْخَمْرِ يُعَذِّبُهُ اللَّهُ بِسِتِّينَ وَثَلَاثَ مِائَةَ نَوْعٍ مِنَ الْعَذَابِ."

³⁸ "Biharul Enuar", vëll. 79, f. 152.

Hadithi 36

Alkoolisti nuk e fiton shefatin e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Ai që pi pije dehëse, nuk e fiton shefatin tim dhe betohem në Allah, se ai nuk do të vijë te unë te Burimi (Haudhi)”.³⁹

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:
وَلَا يَنْالُ شَفَاعَتِي مَنْ شَرِبَ الْمُسْكِرَ، لَا يَرُدُّ عَلَيَّ الْخَوْضَ
لَا وَاللَّهِ.

³⁹ “Uesailu Shiati”, vëll. 17, f. 261.

Hadithi 37

Mos i besoni alkoolistit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Fqinjësia me jehuditët dhe të krishterët është më e mirë se fqinjësia me pirësin e alkoolit. Mos e besoni alkoolistin, sepse të besuarit e tij është pendim”.⁴⁰

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:
"مُجَاوَرَةُ الْيَهُودِ وَ النَّصَارَى خَيْرٌ مِنْ مُجَاوَرَةِ شَارِبِ الْخَمْرِ،
وَ لَا تُصَادِقُوا شَارِبَ الْخَمْرِ فَإِنَّ مُصَادِقَتَهُ نِدَامَةٌ.

⁴⁰ "Biharul Enuar", vëll. 79, f. 152.

Hadithi 38

Alkooli është sëmundje

Sueijd ibn Tarik e pyeti Profetin Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) rreth alkoolit dhe i tha: “Unë e përdor për ilaç atë”. Profeti iu përgjigj: “Ai është sëmundje dhe nuk është ilaç”.⁴¹

سُوَيْدُ بْنُ طَارِقٍ سَأَلَ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ عَنِ الْخَمْرِ، فَهَبَّاهُ
فَقَالَ:

أَصْنَعُ لِلدَّوَاءِ فَقَالَ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ: إِنَّهَا دَاءٌ وَ لَيْسَتْ بِدَوَاءٍ

⁴¹ “Kenzul Ummal”, vëll. 5, Hadithi 13756.

Hadithi 39

Alkoolisti ka për shokë shejtanin

I Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Nëse robi nuk pi pije alkoolike, do të jetë ende në rrugën e gjerë të fesë së tij. Kur ai e pi atë, Allahu ia heq atij mbulesën dhe shejtani do të jetë mbrojtësi i tij. Dëgjimi dhe shikimi i tij do ta drejtojnë atë në çdo të keqe dhe do ta largojnë atë nga çdo e mirë”.⁴²

عَنْ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:

لَنْ يَزَالَ الْعَبْدُ فِي فُسْحَةٍ مِنْ دِينِهِ مَا لَمْ يَشْرَبِ الْخَمْرَ وَإِذَا شَرِبَهَا
حَرَقَ اللَّهُ عَنْهُ سِتْرَهُ وَكَانَ الشَّيْطَانُ وَلِيَّهُ وَ سَمِعَهُ وَ بَصَرَهُ يَسُوقُهُ إِلَى
كُلِّ شَرٍّ وَ يَصْرِفُهُ عَنْ كُلِّ خَيْرٍ.

⁴² “Nehxhul Fasahati”, Hadithi 2291.

Hadithi 40

Alkoolisti është si adhuruesi i idhujve

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Alkoolisti është i mallkuar. Alkoolisti është si adhuruesi i idhujve dhe në Ditën e Kiametit do të tubohet me Faraonin dhe Hamanin”.⁴³

قَالَ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَآلِهِ:
شَارِبُ الْخَمْرِ مَلْعُونٌ، شَارِبُ الْخَمْرِ كَعَبْدَةِ الْأَوْثَانِ، يُحْشَرُ يَوْمَ
الْقِيَامَةِ مَعَ فِرْعَوْنَ وَهَامَانَ.

⁴³ “Biharul Enuar”, vëll. 79, f. 141.

Po e mbyllim këtë libërth me
përmendjen e ajetit 63 të sures “En Nur”:

فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ
أَلِيمٌ

**“...Le të frikësohen ata që kundërshtojnë
urdhrin e tij (të Profetit), që të mos i
godasë ndonjë sprovë (e keqe) ose që të
mos i godasë një dënim i dhembshëm.”**

Ky paralajmërim ndaj shkeljes së
urdhrit të Allahut është i vlefshëm edhe
për ata që bëjnë mëkate, veçanërisht
mëkate të mëdha, siç është pirja e alkoolit,
për të cilin Allahu ka caktuar për
përdoruesit e tij zjarrin e Xhehenemit.

Qofshim larg mëkateve e gjynaheve!

Alkooli, nëna e të këqjave

اسم الكتاب: الكحل أم الخبائث

المترجم: الحاج الشيخ ولنت مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا

تيرانا: 2023